



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI QARKUT DURRËS

ANALIZA E PUNËS PËR SEKTORIN E FINANCËS E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

PËR VITIN 2020

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Prefektit të Qarkut Durrës, gjatë vitit 2020 e ka mbështetur punën e saj në zbatim të ligjshmërisë dhe objektivave të shtruara për realizimin e tyre në të gjithë veprimtarinë e këtij sektori, në zbatim të ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjeve e udhëzimeve specifike në fushën e financës.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2020, megjithëse ishte një periudhë e vështirë pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, të Covid -19 dhe me mungës personeli, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim dhe me sektorët e tjerë të Prefektit të Qarkut Durrës, në zbatim të planit vjetor të punës të hartuar më parë, bëri të mundur realizimin e objektivave si më poshtë:

I. Brenda muajit Janar 2020, u detajua buxheti i ri për vitin 2020 për administratën e Prefektit dhe Gjendjen Civile i cili u dërgua brenda afatit në Ministrinë e Brendshme e Degën e Thesarit. Po kështu u hartuar Rregjistri i realizimit të Prokurimit Publik për vitin 2019 si dhe u hartuar e miratua Rregjistri i parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2020 të cilët u dërguan brenda afatit në Ministrinë e Brendshme dhe Degën e Thesarit.

II. Në zbatim të Urdhërit nr.7 prot datë 19.01.2020 të Prefektit të Qarkut Durrës është përcaktuar struktura e administratës së Prefektit me 28 punonjës, (bashkë me 2 punonjës të gjendjes civile) sipas pozicioneve të punës dhe me emrat e punonjësve. Gjatë muajit Gusht - Shtator nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike u realizua procedura për emërimin e dy përgjegjësve të sektorit atij të financës dhe atij të zhvillimit urban. Nga DAP janë hapur procedurat dhe janë bërë emërimet në fund të muajit dhjetor 2020 për 4 vende vakant; dy specialist në Sektorin e Emergjencave Civile, dy specialist në Sektorin e Zhvillimit Urban, si dhe janë hapur procedurat për 1 specialist në Sektorin e Monitorimit të Kopetencave Vendore. Gjatë gjithë kësaj periudhe kanë qenë në marrëdhënie pune 21 punonjës, për të cilët janë kryer në afat hartimi i listpagesave, përlllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë.

Mbeten dhe dy vende vakant; 1 specialist finance në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe 1 specialist në Sektorin Juridik.

III. Gjatë vitit 2020, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka ndjekur përdorimin dhe administrimin e fondeve të vëna në dispozicion për aparatin e Prefekturë dhe atë të Gjendjes Civile. Kemi raportuar çdo muaj, evidencat e realizimit të treguesve buxhetorë në Ministrinë e Brendshme dhe në Degën e Thesarit.

Në mënyrë analitike realizimi i fondeve buxhetore është si më poshtë:

Shpenzime buxhetore në total, janë realizuar në masën 90 %%. Konkretisht nga 28.004 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 25.092 mijë lekë, pra më pak 2.912 mijë lekë.

1-Pagat e personelit (artikulli 600) janë realizuar në masën 96 %. Konkretisht nga 18.600 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 17.928 mijë lekë, pra më pak 672 mijë lekë. Ky kursim ka ardhë si pasojë e vendeve të pa plotësuara në organikë.

2-Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601) është realizuar në masën 77%. Konkretisht nga 3.790 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 2.909, pra më pak 881 mijë lekë, kursim ky që lidhet me kursimin e fondit të pagës.

3-Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (artikulli 602) janë realizuar në masën 76%. Konkretisht nga 5.505 mijë lekë të planifikuara në fakt janë shpenzuar 4.195 mijë lekë, pra më

pak 1.310 mijë lekë. Ky mos shpenzim në shumë shumën prej 780 mijë lekë ka ardhë si rezultat i fillimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit të Prefekturës nga data 15.04.2020 si dhe nga konkurrenca e bërë nga zhvillimi i procedurave të prokurimit.

Duke i analizuar shpenzimet operative sipas strukturës ato paraqiten si më poshtë:

-Materiale zyre dhe të përgjithshme, (kancelari, materiale pastrim e dezinfektimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, furnizime e materiale të tjera zyre), janë realizuar 91% ;

-Shërbimet nga të tretët (telefona, energji, ujë, shërbim postar, ruajtje fizike e godinës, faqja zyrtare, shërbim interneti dhe shërbime të tjera), janë realizuar 90%;

-Shërbimet e transportit (naftë, pjesë këmbimi), janë realizuar 78%;

-Shpenzime udhëtimi janë realizuar 48% ;

-Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme janë realizuar 57%;

4-Të tjera transferata tek individët (artikulli 606) janë realizuar në masën 54%.

IV. Është bërë ndjekja e realizimit të të Ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor 2020 të cilat raportohen periodikisht në Ministri dhe janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit Durrës. Për këtë periudhë të ardhurat janë realizuar në total 506.000 lekë, nga të cilat 25.300 lekë, të ardhurat për Ministrin e Brendshme dhe 480.700 lekë, të ardhurat për Buxhetin e Shtetit.

V. Gjatë këtij viti së bashku me komisionet përkatëse (komisioni i testimit, prokurimit dhe ai i marrjes në dorëzim), janë realizuar 9 procedura prokurimi me vlerë të vogël, nga 13 të planifikuara. Nga procedurat e përcaktuara janë riparimi dhe mirëmbajtja e banjove të Institucionit, blerje pjesë këmbimi goma dhe bateri, shpenzime për mirëmbajtje mjete transporti dhe shpenzime për mirëmbajtje pajisje zyresh. Gjithashtu është dërguar në APP rregjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik për çdo katër muaj si dhe ai vitit 2020.

VI. Është realizuar mbajtja e sistemit të kontabilitetit të vlerave monetare dhe materiale, lëvizjen e aktiveve, raportim për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, përgatitja e pasqyrave financiare të institucionit dhe depozitimi në degën e thesarit dhe Ministrinë e Brendshme.

VII. Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Janë realizuar në total 113 aktivitete dhe takime të ndryshme, të cilat janë publikuar si në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale.

VIII. Përpunimi dhe shpërndarja e korrespondencës, nisja brenda afateve kohore të të gjithë dokumentacionit që del nga institucioni si dhe përgatitje dhe dërgimi i evidencave statistikore tre mujore Zyrës Rajonale të Statistikës Durrës.

Disa probleme që kanë dalë gjatë vitit, ku një pjesë e të cilave janë realizuar, në funksion të realizimit të detyrave si dhe për një funksionim më të mirë e më efikas të punës në Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe në atë të administratës së Prefektit.

-Si rezultat i defekteve në rrjetin elektrik, të ndodhura në mënyrë të herë pas hershme nga amortizimi i rrjetit elektrik u bë e mundur riparimi tërësor i tij në të gjithë Institucionin Prefektit të Qarkut Durrës.

-Në drejtim të krijimit të kushteve më të mira në ambientet e zyrave të Prefekturës, si pasojë tërmetit të nëntorit të vitit 2019 e sidomos pas riparimit të rrjetit elektrik është bërë e domosdoshme lysterja të gjithë ambienteve të Prefekturës me fondet e vetë institucionit të planifikuara për vitin 2021.

-Po kështu janë të dëmtuara dhe amortizuara tualetet e Institucionit për të cilat janë kërkuar fonde për investime për rikonstruksionin e tyre në buxhetet e viteve 2020 dhe 2021. Në bashkëpunim me Ministrinë për të na akorduar një fond për investime, mendojmë që ky problem do të zgjidhet.

Përgjegjësi i Sektorit të Financës e Shërbimeve Mbështetëse

VESELI RUSTANI